Kronikë

Atentati ndaj ish deputetit në Kurbin, shkak debati për numërimin e 2 votave që përfundoi në përplasje fizike! Ende në kërkim djali i vëzhguesit të 'BF'

Konflikti për votat është bërë shkak për ngjarjen e ndodhur pasditen e së mërkurës në Kurbin, ku u qëllua me armë makina e ish-deputetit të Partisë Socialiste Armando Prenga. Në këtë konkluzion ka dalë policia pas vepriminve hetimore të kryera dhe pyetjes së personave që kishin dijeni rreth ngjarjes.

■ Atentati ndaj Armando Prengës në Kurbin, babai i autorit të dyshuar: Vëllai i ish deputetit më ka dhunuar gjatë numërimit të votave në KZAZ

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
18 Maj, 12:21 | Përditësimi: 18 Maj, 16:10

Konflikti për votat është bërë shkak për ngjarjen e ndodhur pasditen e së mërkurës në Kurbin, ku ***u qëllua me armë*** makina e ish-deputetit të Partisë Socialiste Armando Prenga. Në këtë konkluzion ka dalë policia pas vepriminve hetimore të kryera dhe pyetjes së personave që kishin dijeni rreth ngjarjes.

Sipas burimeve vëllai i ish-deputetit është përplasur fizikisht me babain e autorit të dyshuar të ngjarjes, i cili ishte vezhgues i koalicionit opozitar Bashkë Fitojmë. Gjithçka ndodhi pas kontestimit të dy votave në një kuti votimi, ndërsa për normalizimin e situatës, ditën e hënë u desh ndërhyrja e policisë.

LEXO EDHE:
Kadilli: Ka anëtarë të Rithemelimit që duan largimin e Berishës, nuk kanë kurajo ta thonë! Bejko: Në fushatë, jam penguar nga disa figura të PD-së

Këta të fundit kryen të gjitha veprimet në lidhje me rastin dhe materialet hetimore u referuan në prokurori me një person të proceduar penalisht, i cili rezulton të jetë vëllai i ish-deputetit socialist, ndërsa rezulton se ky i fundit nuk ka qenë në ambientet e KZAZ në momentin e konfliktit verbal. Por kjo situatë duket se nuk është pritur mirë nga djali i vëzhguesit të opozitës Fatbardh Ismaili.

Dy ditë më vonë 29-vjeçari ka tentuar të marrë hak, duke qëlluar në drejtim të automjetit të ish-deputetit Armando Prenga i cili po lëvizte i vetëm në aksin rrugor Laç-Mamurras. Autori qëlloi pilot tre herë ndaj, tij por fatmirësisht asnjëri nga plumbat nuk e prekur 49-vjeçarin i cili njoftoi menjëherë policinë për atë çfarë i kishte ndodhur.

Bluté u vunë menjëherë në lëvizje, por pa arritur të lokalizojnë dhe prangosin e autorin e kësaj ngjarje i cili u largua me një automjet tip Benz. Për kapjen e tij që prej ditës se mërkure janë angazhuar dhjetëra forca policore, por pa mundur ende që ta lokalizojnë. 29-vjeçari Fatbardh Ismaili do të përballet me akuzat Kanosja me armë dhe mbajtja pa lejeve e armeve të zjarrit.

Për ngjarjen ka folur edhe Islam Ismaili, babai i autorit të dyshuar të atentatit. Ai tha se nuk kishte dijeni nëse ishte djali i tij ai që e ka kryer atentatin ndërsa shtoi se nuk kishte dijeni mbi vendndodhjen e këtij të fundit. Vëzhguesi i BF, pretendoi se është dhunuar në KZAZ nga Arben Prenga, vëllai i ish deputetit, Armando Prenga.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 15:54

Atentati ndaj Armando Prengës në Kurbin, babai i autorit të dyshuar: Vëllai i ish deputetit më ka dhunuar gjatë numërimit të votave në KZAZ

Detaje të reja jane zbardhur në lidhje me atentatin me armë ndaj ish deputetit të PS Armando Prenga, pasditen e së mërkurës në Fushë-Kuqe të Kurbinit. Në lidhje me rastin është marrë në pyetje Islam Ismaili, babai i autorit të dyshuar Fatbardh Ismaili.

Në deklarimet e tij në polici, Islam Ismaili ka deklaruar se është dhunuar nga vëllai i ish deputetit socialist, Armando Prenga gjatë numerimit të votave në KZAZ -në 15 në Kurbin, por nuk ka dijeni se nëse djali i tij është autor i atentatit duke shtuar se nuk ka asnjë informacion mbi vendndodhjen e tij. Gjithashtu në pyetje, policia mori dhe Arben Prengën, i cili pranoi konfliktin me babain e autorit të krimit, por shtoi se nuk kishte asnjë dijeni se çfarë kishte ndodhur në aksin të Fushë-Kuqes, ku Armando Prenga u qëllua me armë.

A.M./B.V/Shqiptarja.com

TAG: zgjedhjet vendore 2023 Lezhë Kurbin Armando Prenga PS

Komento

Komente

Gjergj: 18/05/2023 15:54

Familjes Ismajli,i urojë që ajo që ata kanë luftuar për ta mënuar deri më sot,,,SHTETI SHQIPTAR,,,,ë funksionojë siç duhet, ndrysha, bëjnë varrimet gati sepse askush nuk u shpëton dot. Ai, që përfaqësoni ju politikisht, është ndjellësi i gjithë këtyre ngjarjeve sot. Kur të hapesh prapanicash dhe mendon se je i fortë,,,mendo për një moment të luten,,,se dikush është ca më i fortë se ti. Jo se ju meritoni mbrojtjen e shtetit,,,sepse kur ju sheh dhe dëgjon njeriu se çfarë "xhevahiresh" rairmi nga goja,,mendon me vete,,,do e gjesh hundleshin, mos ki merak. ,Ju, e kini gjetur. Nëse kini dyshim në këtë,,,pyesni atë deputetin Strazimiri,,ai me kobuze në brez që mendonte kështu e ashtu,,,se si shjion rrysi i pantallonave në qafë, pas fshikullimave në sallën e kuvendit? Çfarë mëdlini,,do kormi.!!!

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si e vlerësoni vendimin e Alibeajt për dorëheqje nga drejtimi i PD?

I drejtë | I gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Dhëndri i Berishës shpërthen ndaj qytetarëve të Tiranës, që votuan Veliajn: E gëzofshi këtë mashtrues
18 Maj, 21:24

Mos sulmoni qytetarin që shet votën, por gjeni kurajën e ngrihuni kundër klasës politike
Alban Daci
18 Maj, 21:12

Lëreni mënjanë refrenin "na vodhën dhe na blenë votat", keni dalë më keq se në '97-n
Endri Tafani
18 Maj, 20:24

Ylli Pata: Pse destabilizoi Sali Berishën dorëheqja e Alibeajt?!
Ylli Pata
18 Maj, 19:16

Bejko në Report Tv: Fushata jonë përçoi shpresë, 3 arsyet pse si kandidat mora më pak vota se partia! Në PD persona 'që lëvizin fijet'! Berisha u braktis nga demokratët
18 Maj, 18:30

Valteri: Këllinçi nuk kandidoi për të fituar Tiranën por për të marrë drejtimin e PD! PL fitoi në zgjedhje! Gashi: Rama do ishte dorëhequr nëse opozita s'do ishte e përçarë
18 Maj, 17:54

'Vendoret', ish themeluesi i PD në Report Tv: S'janë njëdhur vota në Shkodër! Opozita? S'është alternativë, është mbushur plot me krijesa të Berishës
18 Maj, 17:53

30 objekte të trashëgimisë kulturore në Lezhë në degradim, historiani Trashaj: Asnjë vëmendje në 3 dekada, po humbin historinë
Elvis Hila
18 Maj, 17:25

Numërimi për vendoret e 14 majit, KRIIK: Proces i çetë, u përfundua më shpejt se zgjedhjet e mëparshme! Policia të ndjekë rastet e denoncimit
18 Maj, 17:19

14 Maji në Shkodër, ose kronika e një ndryshimi të vonuar të paralajmëruar!
Musa Kurtulaj
18 Maj, 16:52

Edi Rama 'fallxhor' i zgjedhjeve, jo
Vitjon Nina
18 Maj, 16:42

E vërteta e shifrave / Foltorja e Berishës vetëm 37 mijë vota më shumë sesa PD-ja e Bashës! A duhet që Rithemelimi të lirojë selinë?
Adriatik Doci
18 Maj, 16:22

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje